



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË

Nr. _____ prot

Korçë, më 05/ 04/ 2018

Lënda: Kriteret e pranimit në programet e studimit të Universitetit « Fan S. Noli » për vitin akademik 2019-2020

MINISTRISË SË ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr.2641 prot./ datë 08.03.2018 “Për kriteret e pranimit në programet e studimit të IAL për vitin akademik 2019-2020” dhe bazuar në Ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 74, pika 2, neni 76, pika 3, ju lutemi gjeni bashkëngjitur tabelat që specifikojnë detajimet e secilit program studimi, sipas propozimeve të Njësive Bazë bazuar në nenin 25, pika 8 të ligjit të mësipërm dhe miratimit nga Senati Akademik i Universitetit “Fan S. Noli”.

- *Vendimi i Senatit përcakton që për programet e studimit Administrim Biznesi në Marketing, Administrim Biznesi në Turizëm, Menaxhim, Matematikë Fizikë, Matematikë Informatikë dhe Teknologji Informacioni, 50% të vlerësimit do ta zërë nota mesatare e llogaritur sipas VKM-së nr. 346, datë 19.04.2017 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018” dhe 50% mesatarja e grup lëndëve të vlerësuara si të rëndësishme për vetë profilin e programit.*
- *Për programet e studimit “Mësuesi për Arsimin Fillor Klasa I-VI”; “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”; “Gjuhë dhe Kulturë Frënge” vlerësimi i kandidatëve do të bëhet duke marrë për bazë 100% notën mesatare të llogaritur sipas VKM-së nr. 346, datë 19.04.2017 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018”*
- *Për të gjithë programet e tjera të studimeve ky raport do të jetë 70% të vlerësimit do ta zërë nota mesatare e llogaritur sipas VKM-së nr. 346, datë 19.04.2017 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet*

e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018” dhe 30% mesatarja e grup lëndëve të vlerësuara si të rëndësishme për vetë profilin e programit.

- *Mesatarja e grup lëndëve llogaritet si mesatare e thjeshtë e notave të grup lëndëve të marra nga kandidatët gjatë gjithë viteve të studimit në arsimin e mesëm të lartë.*

- *Për programin e studimit “Gjuhë Angleze” për llogaritjen e mesatares së grup lëndëve të specifikuar do të merren parasysh edhe koefiçentët e shkollave të mesme që janë bashkëngjitur këtij materiali. Në këtë rast formula e llogaritjes së pikëve do të jetë $(0,7x \text{ nota mesatare e përgjithshme}) + (0,3 \times \text{nota mesatare e grup lëndëve të profilit}) \times \text{koefiçenti i shkollës së mesme}$.*

- *Për programin e studimit 2 vjeçar me karakter profesional “Edukim për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme” kriteri i vetëm është kryerja e Arsimit të Mesëm të Lartë.*

FB: Matura Shtetërore 2019
IG: @matura.shteterore

REKTORI
Prof. dr. Ali Jashari